




Fondi i Grave të Kosovës

Grante të Vogla,
Ndryshime të Mëdha





Përmbajtja

Për Fondin e Grave të Kosovës	4
Si funksionon Fondi i Grave të Kosovës?	6
<i>Vita-Jeta</i> diagnostifikon osteoporozën	8
Gratë e verbëra mësojnë të pregatisin ushqim	10
Gratë avokojnë shitjen e produkteve tradicionale te Kryetari i Prishtinës, si dhe te Presidentja	12
<i>OJQ Ato</i> ofron edukim shëndetësor	14
Gratë marrin njohuri për shtatëzëninë	15
Personat me distrofi muskulare krijojnë strategji	16
Gratë e Dragashit luftojnë kancerin e gjirit	18
Të mbijetuarat e dhunës seksuale kërkojnë drejtësi	20
Gratë marrin njohuri mbi shëndetin	22
Gratë avokojnë për t'i dhënë fund dhunës	23
Gratë vizionare shpalojnë aktivitetin	24
Gratë me aftësi të kufizuara kanë qasje në kujdes shëndetsor	26
Dy fjalë për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës	27

Për Fondin e Grave të Kosovës

Në vjeshtën e vitit 2012, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka dhënë 12 grante, që arrijnë shumën prej 10,209 €, për organizatat anëtare të saj përmes Fondit të Grave të Kosovës. Nga këto iniciativa **përfituan 928 gra nga zona të ndryshme** duke përfshirë edhe gratë me aftësi të kufizuara fizike, zonat rurale, të etnive të ndryshme (p.sh., turke, gorane, serbe, rome, ashkali, egjiptiane dhe shqiptare), të rinjtë dhe pensionistët. Shumë më tepër njerëz kanë përfituar në mënyrë të tërthortë brenda komuniteteve të tyre. Këto grante të vogla (deri në 1,000 €) kanë bërë ndryshime të mëdha në një periudhë të shkurtër kohore. Kjo broshurë tregon historitë e tyre.

Por fillimisht, dëshirojmë të ju njoftojmë pak me historikun e Fondit të Grave të Kosovës. Me mbështetjen permanente

të Kvinna till Kvinna, RrGGK themeloi këtë fond për të siguruar grante të vogla për organizatat e grave që nuk kanë qasje në burime tjera të financimit. Fondi i Grave të Kosovës u krijua pas shumë konsultimeve me 100 organizatat anëtare të RrGGK-së lidhur me nevojat dhe vizionin e tyre për Fondin.

“U ndjeva pjesë e një iniciative të mrekullueshme që ndryshoi jetën e grave në zonat rurale.”
- Përfituese e grantit

Fondi i Grave të Kosovës plotëson nevojën elementare për të mbështetur organizatat e grave në komunitet në mes të zhvendosjes së prioriteteve të ndihmës në Kosovë. Zvogëlimi i buxheteve ka detyruar shumë donatorë në Kosovë që të mbyllin programet e tyre të granteve ose të ulin fondet për organizatat jo-qeveritare. Donatorët tjerë kanë fonde që për organizatat lokale janë jashtëzakonisht të vështira për t’iu qasur. Grupet e grave që se njohin mirë gjuhën angleze ngecin në marrjen e fondeve të tilla. Megjithatë, organizatat e udhëhequra nga gratë janë të pozicionuara mirë për të ndërmarrë iniciativa shumë efikase dhe efektive drejt barazisë gjinore dhe të drejtave të grave në nivel komunal, ashtu siç ka dëshmuar Fondi i Grave të Kosovës. Nëpërmjet Fondit të Grave të Kosovës, ne

përpiqemi që të sigurohemi që përpjekjet e tyre të rëndësishme të vazhdojnë të pranojnë mbështetje.

Në vitin 2013 dhe 2014, RrGGK do të sigurojë së paku 60,000€ në vit grante për anëtarët e saj, mbështetur nga Austria Development Agency (ADA) dhe Kvinna till Kvinna (KTK). Poashtu ne jemi duke kërkuar fonde shtesë dhe planifikojmë rritjen e vazhdueshme të Fondit të Grave të Kosovës.

Të Arriturat Kryesore të Fondit të Grave të Kosovës

- **928 gra përfituan deri tani**
- **Ka rritur kapacitetin e anëtareve të RrGGK-së për të shkruar projekt propozime**
- **Anëtare të ndryshme të RrGGK-së, përfshirë edhe grupet rurale dhe të minoriteteve, kanë qasje unike në fonde**
- **Zyrtarët për Barazi Gjinore të komunave dhe institucionet tjera të përfshira në iniciativat e anëtareve të RrGGK-së**
- **Anëtarët e RrGGK-së ofruan bashkë-financim të konsiderueshëm për iniciativat e tyre**
- **Kërkesë e madhe për vazhdimsinë e Fondit të Grave të Kosovës**

Si funksionon Fondi i Grave të Kosovës?

Tri herë në vit, 100 organizata të ndryshme të RrGGK-së inkurajohen që të dorëzojnë aplikacione për iniciativa që do të kontribuojnë në realizimin e qëllimeve strategjike të identifikuara në Planin Strategjik të RrGGK-së për vitet 2011-2014. Anëtarët e RrGGK-së vetë i kanë përzgjedhur këto qëllime përmes një procesi konsultativ. Ato përfshijnë:

- Fuqizimin e RrGGK dhe anëtareve të saj
- Mbështetjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimarrje
- Përmirësimin e kujdesit shëndetësor sa më kualitativ
- Luftën kundër dhunës në familje dhe trafikimit të personave
- Fuqizimin ekonomik të grave

Organizatat e grave mund të aplikojnë për fonde në gjuhën shqipe apo serbe, duke përdorur Formën e Aplikimit që gjendet në uebfaqen e RrGGK-së (www.womensnetwork.org). Për të aplikuar për grante të Fondit të Grave të Kosovës, organizata duhet të jetë anëtare e RrGGK-së; të planifikojë dhe implementojë aktivitete në përputhje me strategjinë e tyre organizative; të ndër marrë aktivitete që kontribuojnë në Planin Strategjik të RrGGK; të arrijë tek komuniteti dhe/ose personat dhe grupet e marginalizuara; dhe nëse iu mungojnë mundësitë tjera të sigurimit të fondeve.

Duke filluar nga Janari i vitit 2013, iniciativat e mbështetura nga Fondi i Grave të Kosovës mund të zgjasin deri në gjashtë muaj dhe të marrin deri në 3,000 €, edhe pse shuma dhe afati kohor mund të rriten në rast se RrGGK siguron fonde shtesë. Komisioni Përzgjedhës për Grante i Fondit të Grave të Kosovës, i përzgjedhur në baza vjetore nga anëtarët e RrGGK-së, takohet tri herë në vit për të vendosur nëse projekt propozimet i përmbushin kriteret e lartëpërmendura dhe për të miratuar grantet duke përdorur një sistem të bazuar në mbledhjen e pikëve.

RrGGK gjithashtu ofron mundësi për zhvillimin e kapaciteteve për aplikantët e granteve dhe përfitueset e granteve për të forcuar

organizatat tona anëtare dhe rrjetin tonë. RrGGK ofron punëtori konkrete, si dhe mentorim individual në shkrimin e granteve, menaxhim të ciklit të projekteve dhe menaxhim financiarë, duke përkrahur më tutje kapacitetet e organizatave për të aplikuar për fonde nga donatorët e tjerë në të ardhmen.

Mbështetja e RrGGK-së për përfituesit e granteve nuk përfundon sapo të jetë ndarë granti. Ne vazhdojmë të ofrojmë mentorim një-për-një për secilin përfitues të granteve përgjatë iniciativës së tyre dhe shpesh edhe më pas. Kjo përfshin vizita në teren, ndërtimin e shkathtësive në

menaxhim financiar, ndihmë lidhur me menaxhimin organizativ, këshillime lidhur me strategjitë efektive avokuese, lehtësimi i rrjetëzimit me zyrtarë qeveritarë dhe zgjidhjen e problemeve. Ne poashtu mbështesim anëtarët tona në të menduarit proaktiv lidhur me qëndrueshmërinë, që përfshinë planifikimin e iniciativave dhe përfitimin e mbështetjes në nivel të komunitetit që do t'iu mundësojë që iniciativat e tyre të vazhdojnë edhe pas këtyre projekteve të shkurtëra.

Për më shumë informata lidhur me Fondin e Grave të Kosovës, ju lutem vizitoni uebfaqen tonë:

<http://www.womensnetwork.org/?FaqlD=33>. Anëtarët e stafit të RrGGK-së mund t'iu ofrojnë informata shtesë përmes e-mailit në grants@womensnetwork.org ose përmes telefonit në +381 (0)38 245 850. Ju lutem na kontaktoni nëse ju apo organizata juaj jeni të interesuar të përkrahni Fondin e Grave të Kosovës.

“RrGGK u tregua e suksesshme në ofrimin e shërbimeve për anëtarët e saj. Puna e madhe e stafit të RrGGK-së është e dukshme përmes përkrahjes që i japin OJQ-ve të vogla, në mënyrë që OJQ-të ndihen të fuqizuara.”
- Anëtare e RrGGK

***Vita-Jeta* diagnostifikon osteoporozën**

Duke pasur parasysh mungesën e njohurive rreth osteoporozës në mesin e grave të moshuara në Kosovë, si dhe natyra e vështirë e konstatimit të kësaj sëmundje, *Vita-Jeta*, shoqatë me rreth 850 gra pensioniste, filloi një fushatë informuese në lidhje me këtë sëmundje. Kjo shoqatë organizoi një ligjeratë mbi osteoporozën dhe ofroi ekzaminime mjeksore pa pagesë për diagnostifikimin e kësaj sëmundje.

"Edhe pse unë kam punuar si infermiere, kurrë nuk e kam vërejtur se vuaja nga osteoporoza" thotë Remzije Pireva, anëtare e Vita-Jeta. "*Vita-Jeta* më mundsoi që nëpërmjet tyre të marrë iniciativën për të bërë testin për diagnostikimin e kësaj sëmundje". Që atëherë ajo ka ndjekur urdhëzimet e mjekut dhe ka marrë barërat e përshkruara. "Tani unë ndjehem shumë më mirë," tregon ajo.

Remzija është një ndër 243 gratë e pensionuara të cilat kanë bërë testin e osteoporozës të organizuar nga *Vita-Jeta*. Nëpërmjet këtyre testeve falas, pothuajse një e treta e grave kanë konstatuar se vuajnë nga osteoporoza. Sikur Remzijas, disave iu është mundësuar trajtimi duke iu falemnderuar përfaqësuesëve të Vita-Jeta të cilat kanë bindur një farmaci vendore që të sigurojë barëra falas për pensionistet që jetojnë në kushte të vështira ekonomike.



Gratë presin për të vënë emrat e tyre në listen ditore për kontrollim mjekësor pa pagesë.



*Një grua
kontrollohet për
osteoporozë në
Prishtinë, tek
Vita-Jeta.*

"Ne jemi të interesuara për të ofruar mundësi të njëjtë për të gjitha anëtarët e OJQ-së tonë", thotë Ajshe Nuhiu, drejtoreshë e OJQ-së *Vita-Jeta*. Ekzaminimet e tilla dhe barnat pa pagesë mund të jetë vendimtare për personat e moshuar që jetojnë në Kosovë, shumë prej të cilave luftojnë për të mbijetuar në kushte të vështira ekonomike.

Vita-Jeta gjithashtu ndihmon anëtarët e saj me terapitë e përshkruara nga mjeku. "Pasi që ato janë anëtare të OJQ-së tonë dhe marrin pjesë rregullisht në takime, është e lehtë për ne për të parë nëse ato janë duke i respektuar këshillat mjekësore" na thotë Ajshe Nuhiu.

Pavarësisht arritjeve të OJQ-së *Vita-Jeta* në vetëm dy muaj, 500 anëtare të tjera të shoqatës janë ende duke trokitur në derën e tyre, duke kërkuar dhe shpresuar se edhe ato do të mund të bëjnë një test diagnostik. Përpjekja e OJQ-së *Vita-Jeta* për ndërgjegjësim ka edukuar anëtarët e tyre në lidhje me rëndësinë e testit.

Përfaqësueset OJQ-së *Vita-Jeta* thonë se ato do të aplikojnë përsëri për grant në Fondin e Grave të Kosovës në mënyrë që të ofrojnë shërbime të ngjashme edhe për anëtarët tjera. Gjithashtu planifikojnë të kërkojnë fonde nga burime të tjera të mundshme, duke përdorur aftësitë e tyre të reja për mbledhjen e fondeve, të zhvilluara me mbështetjen e stafit të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës.

Gratë e verbëra mësojnë të pregatisin ushqim

Yllka mezi pret që të befasojë familjen e saj me gatimin e qofteve tradicionale. Ajo është e verbër dhe pak kush në Kosovë pret që ajo të gatuajë apo të bëjë ndonjë gjë tjetër në këtë drejtim.

Shoqata e të Verbërve në Prizren ka iniciuar për të fuqizuar gratë e verbëra si të bëhen të pavarura. Përmes programit të tyre "Të mësojmë të gatuajmë", Yllka dhe nëntë gra të verbëra kanë mësuar të pregatisin ushqim në mënyrë të pavarur.

Kjo organizatë që është degë e Shoqatës Kombëtare të të Verbërve, ka për qëllim mbrojtjen e integritetit dhe të drejtave të personave të verbër, avancimin e arsimimit të tyre dhe integrimin e tyre në shoqërinë kosovare.

"Natyrshë që është më e vështirë për ato që të mësojnë të pregatisin ushqim, pasi që ato duhet të mësojnë duke u bazuar në prekje", tregon Miradije Buçaj, drejtorshë e organizatës. "Megjithatë, si një grua e verbër dhe nënë e dy vajzave, të përgatitësh ushqim, të kesh shtëpinë e pastruar, ti kesh rrobat e hekurosura si dhe të gjitha punët e tjera në shtëpi ti kesh në rregull, unë mund të them se nuk është e pamundur për këto gra që ti arrijnë të gjitha."



Anëtarët e Shoqatës së Personave të Verbër në Prizren mësojnë të gatuajnë qofte tradicionale.

Përveç mësimit të aftësive të reja, projekti gjithashtu mbledhi gratë së bashku dhe u mundësoi atyre që të krijojnë miqësi. Për gratë që jetën sociale e kanë tejet të kufizuar dhe kanë mungesë të mbështetjes nga familjet e tyre, inkurajimi nga mikeshat e reja, që ballafaqohen me çështje të ngjashme, ofron shumë shpresë për jetë.

"Kjo është një sfidë për ne", tregon Yllka. "Por kjo na ndihmon shumë dhe gjithashtu na ofron mundësinë që të bisedojmë me gratë dhe vajzat tjera të verbëra."

Gratë që morën pjesë në këtë projekt janë të gatshme ti ofrojnë atë çka kanë mësuar edhe të tjerëve që janë të verbër.

"Ky projekt ishte një kënaqësi e veçantë dhe kam mësuar shumë", tregon Valmira Berisha, një pjesëmarrëse tjetër. "Familjet tona, nuk na lejojnë të gatuajmë sepse ne jemi të verbëra. Përvoja e të mësuarit është e jashtëzakonshme. Kam mësuar të gatuaj jo vetëm për veten time, por edhe për të tjerët. Unë jam bërë e pavarur."

"Familjet tona, nuk na lejojnë të gatuajmë sepse ne jemi të verbëra.

Përvoja e të mësuarit është e jashtëzakonshme. Kam mësuar të gatuaj jo vetëm për veten time, por edhe për të tjerët. Unë jam bërë e pavarur."

Gratë avokojnë shitjen e produkteve tradicionale te Kryetari i Prishtinës si dhe te Presidentja

Gratë punuan në mënyrë ekspeditive. Gishtat e tyre të shpejtë fluturonin duke qepur rroba tradicionale. Ato ishin të zëna duke punuar veshje tradicionale për kryetarin e komunës së Prishtinës, Isa Mustafa, si dhe për Presidenten e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga.

Këto veshje të vendosura në një kukull iu kanë dhuruar personaliteteve me shpresë se këta udhëheqës do ti shfaqin këto produkte punë dore të grave në zyrat e tyre për vizitorët. Këto veshje tani e konsiderojnë sallën kryesore të Komunës së Prishtinës si shtëpinë e tyre të re.

Organizata përgjegjëse e këtij projekti, *Arta* nga Prishtina, për këtë iniciativë është mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës i RrGGK-së. OJQ *Arta* ka ofruar trajnime për gratë për punime të artizanateve tradicionale për të përmirësuar gjendjen ekonomike të këtyre grave si dhe ka avancuar integrimin social të grave.



Gratë prezantuan një kukull të veshur me veshje tradicionale në zyrën e Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Presidentes së Republikës së Kosovës, për të promovuar produktet punëdore të krijuara nga gratë.

"Unë jam jashtëzakonisht mirënjohëse për mundësinë që më është ofruar", tha Valbona Durmishi. Ajo kishte fituar të holla me punë-dore, gjë që e fuqizoi ekonomikisht. Me paratë e fituara, ajo ndihmon familjen e saj dhe shkollon fëmijët e saj.



Anëtarët e "Arta" thurin veshje tradicionale dhe shoqërohen.

"Puna ime me organizatën më ndihmoi të fitoj të ardhura dhe nuk duhet të mvarem ekonomikisht nga burri apo ndonjë anëtar tjetër i familjes" tregon Hava Bytyqi, një anëtare e OJQ-së *Arta*. "Këtu kam mundësinë të kaloj kohë me mikeshat e mia si dhe të punoj. Unë nuk e kisha mundësinë për të shkuar në shkollë kur isha e re, kështu që ky angazhim është shumë e mirëseardhur për mua pasi që mund të shoqërohem me gratë tjera" vazhdoi ajo.

Sipas Hafije Qyqalla, drejtoreshë e OJQ-së *Arta*, Presidentja Jahjaga dhe kryetari Mustafa premtuan të mbështesin grupet e grave në paraqitjen e këtyre produkteve në disa prej ambasadave të Kosovës në mbarë botën, duke promovuar traditën kulturore të Kosovës.

"Ky ekspozim i artizanateve dhe traditës tonë kombëtare do të fuqizojë ekonomikisht anëtarët tona," impresionohet Hafija.

Këto ngjarje u prezantuan në televizionin publik, mediat sociale dhe në gazeta ditore.

OJQ “Ato” ofron edukim shëndetësor

Gratë në zonat rurale të Kosovës kanë mungesë të informatave rreth shëndetit të tyre në përgjithësi dhe shëndetin riprodhues në veçanti. Prandaj Shoqata e Grave “Ato” organizuan një fushatë për edukim mbi shëndetin e grave dhe vajzave.

Gratë në zonat rurale të Komunës së Vushtrrisë, duke përfshirë fshatrat Pantinë, Druar, Novolan, Oshllan dhe Dru i Madh, moren pjesë në ligjeratat rreth shëndetit riprodhues, mbrojtjes nga shtatzënia e padëshiruar, rritjes së fëmijëve dhe mbi dhunën në familje, përfshirë edhe se si duhet vepruar në situata të dhunës në shtëpi.

“Gratë u shprehen lirisht në lidhje me këto tema dhe nuk hezituan të bënin pyetje”, tha Hazbije Dibrani, një infermiere në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Vushtri e cila udhëhoqi trajnimin. “Unë iu ofrova grave mundësinë për të më vizituar në punë në rast se kanë ndonjë nevojë për ndihmë në lidhje me çështje të tilla”.

Gjithsej 94 gra nga tre fshatra të Komunës së Vushtrrisë fituan njohuri shëndetësore nëpërmjet kësaj nisme.

“Projekti ishte shumë i suksesshëm dhe kërkesat e grave për të vazhduar me trajnime të tilla janë të domosdoshme” shtoi Fikrije Ferizi, drejtoreshë e shoqatës.



Anëtarët e OJQ “Ato” diskutojnë projektin e tyre me përfaqësuesen e RrGGK-së.

Gratë marrin njohuri për shtatzëninë

Organizata Gratë Aktive të Gjakovës organizoi një sërë ligjerata për gratë rome, ashkali dhe egjiptase në Gjakovë për tu njohtuar për shtatzëninë.

"Unë nuk di asgjë si mund të përdor metodat për tu mbrojtur nga shtatzënia e padëshiruar", thotë Tabe Maliqi, një grua që ka marrë pjesë në ligjërata.

"Falë RrGGK-së, rreth 170 gra me arsimim të ulët dhe kushte shumë të vështirra ekonomike tani kanë marrë informata themelore mbi këtë temë", tregon Valbona Rizvanolli, drejtoreshë e OJQ-së Gratë Aktive të Gjakovës. "Për këtë temë ato kishin pak njohuri".

Për shembull, "deri tani kam menduar se periodha e shtatzënisë zgjatë shtatë muaj" thotë një grua. "Nëpërmjet këtij projekti mësova se në të vërtetë shtatzënia zgjat nëntë muaj."

Gratë pjesëmarrëse nuk diskutuan vetëm çështjet e shtatzënisë dhe amësisë; ato gjithashtu shprehën vullnetin e tyre për tu konsultuar me një gjinekologe dhe që dëshirojnë të bëjnë vizita mjeksore. Duke marrë parasysh gjendjen e tyre të mjerë ekonomike, organizata planifikon për të identifikuar një zgjidhje që ato të kenë mundësi për kontrolla të tilla në të ardhmen.



Gratë në Gjakovë mësojnë për shtatzëninë dhe ëmësinë.


Personat me distrofi muskulare krijojnë startegji

Në një seminar dy-ditor të quajtur "Edhe ne kemi të drejta" 30 persona me aftësi të kufizuara diskutuan rreth shërbimeve shtetërore dhe sfidat me të cilat përballen çdo ditë. Pjesëmarrësit erdhën në përfundimin se është përmirësuar pak respektimi i të drejtave të tyre, por mbetet të bëhet edhe shumë punë për integrimin e plotë të tyre në jetën shoqërore.

Organizata e Personave me Distrofi Muskulare organizoi një debat, në të cilën rezultuan tri konkludime:

1. Zbatimi i ligjit për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë organizimin e fushatave për të drejtat e tyre dhe respektimi i rregullores administrative për qasjen e tyre në institucionet publike;
2. E drejta për arsimim, si një e drejtë themelore e njeriut;
3. Avokim tek ministritë përkatëse për të mbështetur njerëzit me aftësi të kufizuara nëpërmjet një skeme të ndihmës sociale.

Seminari gjithashtu ofroi një hapësirë për pjesëmarrësit, të cilët ishin nga rajone të ndryshme të Kosovës, të shkëmbejnë përvojat në lidhje me sfidat që ata përballen dhe se si i qasen ndihmës.



Anëtarë të organizatës Personat me Distrofi Muskulare diskutojnë çështjet me të cilat ballafaqohen dhe zgjidhjet e mundshme.

"Ne ishim së bashku me persona të tjerë me aftësi të kufizuara, që vinin nga komuna të ndryshme, së bashku morem pjesë në seminare për të drejtat e kësaj kategorie të njerëzve, si dhe për aktivitete të ndryshme sportive dhe argëtuese", tregon Resmije Rrahmani, një anëtare dhe një nga themelueset e organizates.

Projekti, i mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës, synon të përmirësojë jetën e njerëzve me aftësi të kufizuara, veçanërisht të atyre me distrofi muskulare përmes rehabilitimit, aktiviteteve argëtuese dhe sportive, informacionit dhe ngritjes së vetëdijes.

Nisma gjithashtu iu ka mundësuar njerëzve me distrofi muskulare për të takuar njerëz të tjerë që përballen me çështje të ngjashme.

"Përmes këtij projekti ne kishim mundësinë të tregojmë aftësitë tona, të diskutojmë, të luajmë së bashku dhe të argëtohemi!"

"Nëpërmjet këtij projekti ne kemi pasur mundësi për të shprehur aftësitë tona, të diskutojnë, të luajmë dhe të argëtohemi së bashku," thotë Yllka Berisha, një anëtare e organizatës. "Për shembull, unë u përpoqa të luaj lojën me shigjeta. Normal që kam pasur vështirësi, por jam argëtuar shumë. Për mua ishte një lojë magjike."

"Duhet të ketë më shumë aktivitete si kjo në mënyrë që ne të tërheqim njerëzit me aftësi të kufizuara të cilët kanë probleme dhe nevoja lidhur me gjendjen shëndetësore, ekonomike dhe arsimore. Duhet të kontaktojmë shoqërinë civile si një shtys për të sensibilizuar opinionin për problemet që ne përballemi", tha Agron Kube, një anëtar i OJQ-së.

Gratë e Dragashit luftojnë kancerin e gjirit

Gratë në Dragash gjithmonë kanë pasur vështirësi për tu vizituar te doktori. Komuna gjendet lartë në malet e jugut të Kosovës, qyteti më i afërt është Prizreni. Transporti publik është i rrallë dhe kushtet e motit shpesh e vështirësojnë udhëtimin. Komuna e Dragashit nuk ka asnjë daktoreshë, dhe vetëm disa persona e konsiderojnë të pranueshme që gratë të kontrollohen nga një doktor mashkull.

Të shqetësuara për mirëqenien e grave në zonën e tyre, Shoqata Iniciativa e Grave u përcaktua për të ngritur vetëdijën në lidhje me rëndësinë e kontrolleve rutinë, veçanërisht në drejtim të diagnostifikimit të hershëm të kancerit.

"Gratë patën mundësi për të takuar një daktoreshë, dhe ti bëjnë pyetje, të flasin hapur, të informohen rreth kancerit dhe të kuptojnë rëndësinë e zbulimit të kancerit të standin e hershëm", tregon Gjejon Lokaj, Kordinatore e Shoqatës së Iniciativës së Grave.

"Në fshatin tonë kjo ishte shumë e nevojshme" thotë Qesbana Pajaziti e cila mori pjesë në takimin që u mbajt në fshatin Lubishtë. "Ne s'kemi pasur njohuri të mjaftueshme në lidhje me kancerin e gjirit, por tani ne jemi të informuara më mirë. Tani jemi në gjendje të kryejmë vetë-ekzaminime për të identifikuar simptomat." Këto njohuri të reja do të ndihmojnë gratë që të mund të zbulojnë shenjat e para të mundshme të kancerit.

"Në fshatin tonë kjo ishte shumë e nevojshme... Tani ne jemi të informuara më mirë. Tani jemi në gjendje të kryejmë vetë-ekzaminime për të identifikuar simptomat."

Përveç kësaj, 182 grave shqiptare, gorane dhe boshnjake, në tetë fshatra të izoluara, iu ofruan kontrolle shëndetsore pa pagesë.

Poashtu rreth 2.500 infermierë, nxënës dhe qytetarë kanë marrë informacione të nevojshme nëpërmjet fushatave mediale në Radio Sharr dhe Radio Gora.

Interesimi i grave për ekzaminim ishte aq i lartë sa që organizata duhej të bënte prioritizimin e pranuesëve. Gratë që kanë pasur histori problematike shëndetësore apo sëmundje në familjet e tyre u kontrolluan së pari. Gratë që nuk u kontrolluan, u këshilluan që të bëjnë përpjekje shtesë për të bërë një vizitë mjeksore, veçanërisht në qoftë se janë mbi moshën 40 vjeçare.

"Mua më pëlqen fakti... që gratë kishin këtë mundësi, se në komunitetin tonë nuk ka doktoresha dhe prandaj duhet ti shkollojmë vajzat që nesër të na kthehen me diploma të mjekësisë" tregon Gjejranja.



Gratë në Dragash diskutojnë luftimin e tyre kundër kancerit të gjirit me vizitoret nga RrGGK.

Të mbijetuarat e dhunës seksuale kërkojnë drejtësi

Të mbijetuarave të dhunës seksuale, krime të kryera gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë, ende nuk iu është dhënë vëmendje e mjaftueshme nga udhëheqësit politikë të Kosovës. Çështja e dhunës seksuale nuk është ngritur në negociatat mes Kosovës dhe Serbisë. Kurrë nuk ka pasur ndonjë kërkim falje zyrtare për krimet e kryera ndaj grave, e poashtu asnjë dënim gjyqësor apo dëmshpërblim.

Në përgjithësi, shoqëria i ka izoluar dhe ka dështuar ti mbështes gratë që pësuan nga ky krim i tmerrshëm. Si rezultat, shumë gra kanë tentuar që të vazhdojnë me jetën e tyre pa mësuar ndonjëherë se si të merren me të kaluarën e tyre në mënyrë psikologjike. Kjo rezulton në sëmundje të ndryshme të pa trajtueshme, duke përfshirë edhe trauma, fobi, frenime në dëshirën seksuale dhe çrregullime të ngrënies, si dhe dëmtime fizike të patrajuara. Identifikimi i grave që kanë vuajtur krime të tilla është qenësor në mënyrë për të ofruar ndihmë shumë të nevojshme në zhvillimin e mekanizmave përballuese që do të mundësojë atyre të jetojnë jetën në mënyrë normale.

Kështu, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve ka përcaktuar për të identifikuar gratë që mbijetuan dhunës seksuale në Drenas. Brenda vetëm disa muajve, ato gjetën 37 të mbijetuara, të moshës 25-50 vjeçare, në 13 fshatra të këtij rajoni.

"Ju ndihmuam shumë grave," tregon Kadire Tahiraj nga Qendra. "Në një rast, një grua e mbijetuar nga dhuna seksuale është identifikuar për herë të parë, dhe projekti i ndihmoi asaj në marrëdhëniet e saj familjare, sidomos me burrin e saj... Burri i saj u ndërgjegjësua se sa e është e rëndësishme mbështetja e tij për gruan në këtë çështje."

Qendra ka hapur këtë temë tabu për diskutim më të gjërë në familjet e disa të të mbijetuarave të dhunës drejt shërimit të tyre.

"Ky projekt ka pasur një ndikim shumë pozitiv dhe ka thyer heshtjen që mbulon këtë çështje për shumë vite", tregon një grua e mbijetuar e dhunës. "Ne ndihemi shumë më të sigurta."

"Ky projekt ka pasur një ndikim shumë pozitiv dhe ka thyer heshtjen që mbulon këtë çështje për shumë vite. Ne ndihemi shumë më të sigurta"
- Grua e mbijetuar

Përtej identifikimit të të mbijetuarave dhe ofrimit të këshillave individuale dhe familjare, organizata solli të mbijetuarat dhe perkrahësit e tyre së bashku për të formuluar tetë kërkesa kryesore në emër të grave të mbijetuara të dhunës. Kërkesa kryesore ishte që të gjithë të respektojnë të drejtat e njeriut të të mbijetuarave të dhunës seksuale dhe nevojat e tyre. Ato i paraqitën kërkesat e tyre Presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga e cila premtoi angazhim maksimal institucional dhe mbështetje të përmirësuar në këtë çështje.

"Tani unë dhe gratë e tjera jemi më të qeta," tregon një grua tjetër që mbijetoj dhunën. "Besimi ynë është ripërtirë se e ardhmja jonë do të jetë më e mirë."

Gratë marrin Njohuri mbi Shëndetin

Shumë gra në Kosovë nuk kanë informata të mjaftueshme në lidhje me shëndetin riprodhues. Përveç kësaj, disa gra nga zonat rurale nuk shkojnë të vizitohen tek mjeku vetëm nëse janë të sëmura. Shoqata për edukim dhe kujdes familjar në Gjakovë filloi iniciativën e tyre për të trajtuar këto dy brenga. Organizata vendosi të ngrisë vetëdijën mbi kujdesin shëndetësor e sidomos kujdesin parandalues, në tri fshatra të komunës së Gjakovës.

"Unë isha në periudhën e menopauzës, por nuk e kuptova që isha shtatzënë deri në muajin e pestë," tregon një grua. "Këtë e mësova vetëm pas sesioneve informuese që ofroj projekti."

Në këto sesione moren pjesë gjithsej 91 gra dhe vajza të etnive të ndryshme.

"Tani ato janë të vetëdijshme për rëndësinë e shëndetit riprodhues, procesit të planifikimit të familjes dhe rëndësinë e vizitave të rregullta te gjinekologu", thotë Bahrije Deva, drejtoreshë e organizatës.

Kjo nismë ka nxitur edhe një ndjenjë të vullnetarizmit në komunitet. "Edhe pse përfundoi projekti, ne kemi vajza vullnetare. Ato mbajnë kontaktet me ne dhe na informojnë në lidhje me nevojat e grave në komunitetet e tyre. Gjithashtu ato kërkojnë ndihmë sipas nevojave të tyre", thotë Bahrije Deva.

Gratë në Gjakovë mësojnë për të drejtat e tyre riprodhuese.




Gratë avokojnë për t'i dhënë fund dhunës

Në një fshat të vogël me 500 banorë gratë rrallë kanë mundësi të flasin për problemet e tyre, sidomos dhunën në familje. Thashethemet do të jetë vështirë të ndalen. *Lepsa Buducnost* iu ka mundësuar grave për tu mbledhur dhe për të diskutuar sfidat me të cilat ato përballen.

"Ishte hera e parë që gratë kishin mundësi të flasin lirshëm për problemet e tyre, veçanërisht problemet që lidhen me dhunën në familje," rrëfen Liljana Stefanoviq. "Është shumë e rëndësishme për ne."

Gjatë një forumi të organizuar nga *Lepsa Buducnost*, 25 gra serbe dhe rome shkëmbyen informata në lidhje me dhunën në familje. Ato diskutuan gjithashtu për mekanizmat e mbrojtjes, mjetet dhe mënyrat e avokimit për të promovuar të drejtat e grave në Prilluzhë. Organizata poashtu shkëmbeu informata edhe me njerëzit tjerë në fshatin e tyre nëpërmjet pamfleteve dhe bluzave me moton "Ndal dhunën"

"Me mbështetjen e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, ne kemi rritur kapacitetin tonë për implementimin e projekteve të vogla", tha Radosava Mirkoviq, drejtoreshë e organizatës. "Ky projekt i vogël bëri ndryshime të mëdha në jetën tonë," tregon ajo.



Radosava Mirkovic e
veshur me bluzën
"Ndal dhunën."

Gratë vizionare shpalojnë aktivitetin

Në Prizren, femrat përballen me sfida të ndryshme që lidhen me përfshirjen në arsim, pavarësimin ekonomik, shëndetin dhe përfshirjen sociale. Organizatat joqeveritare (OJQ-të) e udhëhequra nga femrat janë angazhuar vite me rradhë për përmirësimin e pozitës së grave. Gratë Vizionare të Shekullit XXI, anëtare e RrGGK nga Hasi, kanë promovuar punën e OJQ-ve të grave përmes një fushate mediale. Në këtë mënyrë, gratë vizionare kanë përforcuar vetëdijësimin publik për kontributin pozitiv të OJQ-ve të grave në komunitete në gjithë rajonin e Prizrenit, si dhe kanë ndihmuar organizatat e grave të sigurojnë mbështetje shtesë nga lokaliteti për përpjekjet e tyre.

Ky aktivitet filloi me regjistrimin e biografive nga Gratë Vizionare të Shekullit XXI, që përshkruanin punën e OJQ-ve të grave në rajonin e Prizrenit, duke përfshirë Dora Dore, One to One dhe Shoqatën e të Verbërve. Rrëfimet e tyre më pas u transmetuan në TV Opinon.



*Marte Prekpalaj
prezanton
promovimin e
punës së OJQ-ve
të udhëhequra
nga gratë në TV
Opinion të Prizrenit.*

"OJQ-të në komunën tonë shpesh kanë deklaruar se ato nuk mund të përballojnë që të kenë emisionet e tyre në televizion ose radio," shpjegon Marte Prekpalaj, Drejtoreshë e Grave Vizionare të Shekullit XXI. Kërkesat e tyre frymëzuan atë për të përfituar nga përvoja e saj me mediat lokale në mënyrë që të ndihmojë organizatat e tjera të grave të promovojnë punën e tyre.

Dokumentarët u pranuan mirë nga shikuesit, të cilët thanë që këto programe kishin një ndikim shumë pozitiv në komunitetin lokal.

"Ne nuk ishim në dijeni që OJQ-të e grave kanë bërë kaq shumë punë dhe aktivitete" thotë një shikues.

"Nuk e kemi ditur që OJQ-të e grave kanë bërë kaq shumë punë dhe aktivitete."

- Shikues i televizionit

Për shkak të kërkesës, TV Opinion transmetoi programin vazhdimisht edhe për dy javë më shumë se që kishin planifikuar fillimisht.

Programet gjithashtu theksuan nevojën e OJQ-ve të grave për mbështetjen e vazhdueshme të komunitetit. Të prekur nga këto programe, zyrtarë nga Kuvendi Komunal i Prizrenit kanë ofruar për OJQ-të e grave që të përdorin dy zyra në Prizren falas për kryerjen iniciativave e tyre. Ky kontribut është i rëndësishëm për organizatat e grave që shpesh luftojnë për të siguruar fonde të mjaftueshme për shpenzimet e tyre operative dhe punën avokuese.

Gratë Vizionare të Shekullit XXI shpresojnë që ato do të mund të vazhdojnë të mbështesin organizatat e grave në promovimin e punës së tyre në të ardhmen.

Mbështetja nga Fond i Grave të Kosovës i RrGGK poashtu i ka mundësuar Grave Vizionare të Shekullit XXI të mbajnë një tryezë me 27 gra nga zonat rurale në Ditën Ndërkombëtare kundër Dhunës ndaj Grave.

Gratë me aftësi të kufizuara kanë qasje në kujdes shëndetësor

Bukurije Gashi, nënë e një fëmije me aftësi të kufizuara, ka vuajtur nga kanceri i gjirit. Ajo u operua pesë vite më parë, që nga atëherë ajo nuk ka bërë kontrole të rregullta që iu kanë rekomanduar nga mjeku. "Që tre vite nuk kam pasur mundësi për të vizituar mjekun, sepse unë nuk kam mundësi financiare," shpjegoi ajo. "Prandaj, unë jam shumë mirënjohëse për OJQ-në Gratë për Gratë me Aftësi të Kufizuara, që bëri të mundur që të bëjë një vizitë tek mjeku".

Projekti i kësaj organizate "E dua jetën time ashtu si jam", i mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës, ofroi Pap teste pa pagesë për 10 gra me aftësi të kufizuara të cilat nuk kanë mundësi financiare për teste të tilla për shkak të gjendjes së tyre ekonomike. "Ne gjithashtu sigurojmë trajnime se si të përdoret katedra urinare për gratë ose për anëtarët e familjeve të tyre, kështu që ato nuk duhet të paguajnë për këtë shërbim. Në të njëjtën kohë, këtyre familjeve ju ofrojmë katedra falas", thotë Drita Vukshinaj, drejtoreshë e organizatës.

Përveç kësaj, Gratë për Gratë me aftësi të kufizuara me bazë në Prizren ka siguruar që gratë të marrin mbështetje të qëndrueshme nga Departamenti i Shëndetësisë. "Organizata jonë ka regjistruar me sukses emrat e individëve që përdorin katedra në listën esenciale të Departamentit të Shëndetësisë në kuadër të Komunës së Prizrenit," shpjegoi Drita Vukshinaj. "Ky departament ka premtuar që t'ju ofrojë njerëzve katedra si dhe shërbimin e vërjes në përdorim falas duke filluar nga viti 2013."

Gratë për Gratë me aftësi të kufizuara, punojnë për fuqizim, emancipim, mbrojtje dhe përmirësim të rolit të grave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Organizata gjithashtu trajnon gratë me aftësi të kufizuara mbi parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve të veshkëve.

Dy fjalë për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) angazhohet që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në gjithë Kosovën, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, fetare, etnike, mosha, niveli i arsimit, orientimi seksual dhe aftësia. Ky mission realizohet përmes shkëmbimit të përvojës, rrjetëzimit, avokimit dhe shërbimeve të tjera që ofrohen nga 100 organizata anëtare të RrGGK-së.

Anëtarët e RrGGK-së punojnë drejt qëllimeve që ato së bashku i identifikojnë si të rëndësishme për promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave. Këto qëllime janë të përmbledhura në Planin Strategjik të RrGGK-së për vitet 2011-2014.

Për të mësuar më shumë rreth Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës dhe/ose se si ju mund të përfshiheni në punën tonë, ju lutem na vizitoni në www.womensnetwork.org. Ne poashtu jemi të lidhur në Facebook, kështu që ju lutem vizitoni faqen tonë Kosova Women's Network (Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës). Ju mund të na bashkangjiteni në grupin tonë të Facebook-ut, Kosova Women's Network, për të pranuar përditësime lidhur me punën tonë.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Rr. Hajdar Dushi C-2 II/8

10000 Prishtinë, Kosovë

+381 (0) 38 245 850

www.womensnetwork.org

info@womensnetwork.org

Faqja e Facebook-ut: [Kosova Women's Network](#)